JETA E RE

REVISTË LETRARE

NË DOSSIER:
ALEXANDER KLUGE

2

JETA E RE

REVISTË LETRARE

2

Prishtinë
2025

Avdi VISOKA

VISOKA(1968) është studiues i letërsisë, përkthyes, profesor universiteti. Lindi në Balloc të Podujevës, kurse studimet e gjuhës dhe të letërsisë frënge i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë të Prishtinës.

Studimet pasunirersitare i përfundoi në degën e letërsisë shqipe dhe në Paris. Ka studiuar veprën e Albert Kamysë dhe ka botuar monografinë *Kamy-rrëfimi dhe idetë*. Ka botuar studimet *Koha dhe shkrimi* (1999), Shkrimi dhe receptimi (2016), ka përkthyer nga gjuha frënge *Njeriu i revoltuar* të A. Kamysë dhe ka botuar një numër studimesh në revistat shkencore të Kosovës

NË GJUETI ABSURDI

(Sevdail Zejnullahu: *Pengu i dollisë*. Prishtinë: Faik Konica, 2024)

Me vargun e tij poetik te përmbledhja Çelësin varur në qafë dhe me përmbledhjen me tregime *Pengu i dollisë*, Sevdail Zejnullahu ndërton realitete të mëvetësishme letrare, ku asgjë nuk është ashtu siç duket në shikim të parë. Gjuha e veçantë narrative, sa meditative, sa me origjinë tradite gojore, befasisht shfaqet e çliruar nga rrëfimi klasik, duke krijuar kështu tekste që sfidojnë pritshmëritë e lexuesit. Brenda një konteksti të tillë narrativ, absurdi shfaqet si revoltë ndaj një bote të shndërruar në rutinë e vulgaritet, duke riparë kështu kuptimet tradicionale të jetës, të botës dhe të marrëdhënies së njeriut me to.

Pengu i dollisë është libri i parë me tregime i Zejnullahut, sado që aspak nuk bart shenja të prozës debutuese, duke na sjellë përballë një dore të sprovuar dhe të stabilizuar, me formim të mirëfilltë letrar e me përvojë të pasur jetësore. Autori e njeh dhe zotëron mirë zhanrin e tregimit,dhe e krijon atë natyrshëm, përtej eksperimentimit me formëne strukturën e brendshme.

Të trembëdhjetë tregimet e këtij libri janë të kalibruar përbrenda në sistemin kompleks tematik e stilistikdhe për rrjedhojë lexuesin e mbajnë lidhur deri në fund me botën që shpalosin. Janë temat ato që njëkohësisht përbëjnë unitetin dhe diversitetin e tregimeve dhe të veprës në tërësi. Por, të gjitha tregimet ndërtojnë natyrshëm kompozicionin e librit, duke e përplotësuar, nuancuar dhe begatuar njëritjetrin. Libri ruan një atmosferë unike që i përshkon fund e krye të gjitha tregimet; lajtmotivi mbetet një dhe shkon duke u përplotësuar. Kjo atmosferë në masën më të madhe është univers i absurdit, por te ndonjë tregim ndjejmë edhe njëfarë sensibiliteti surrealist. Një shije të tillë të absurdit, autori e ka ngjyrosur me tone nga veprat e Kafkës, Kamysë, Bucatit e të tjerëve, por me elemente që dallojnë nga autorët shqiptarë të inspiruar nga këta autorë. E veçanta lidhet me afinitetin e autorit që absurdin nuk e shpërfaqin si imitim por si përbrendësim të universit diegjetik, të krijimit të personazheve dhe karaktereve, të aksionevedhe situatave. Tregimii Zejnullahut si formë shprehjeje artistike nuk është vetëm reflektim i realitetit të rëndë, por edhe mënyrë për ta përballuar atë.

Absurdi në tregimet e tij lidhet me përjetimin e një bote që nuk i bindet më logjikës ku njeriu ndjehet i humbur e i tjetërsuar, i zbrazët dhe i paaftë për të gjetur kuptim. Ky stil që e hasim te Kafka, Kamy, Bucati e të tjerë, në tregimet e tij rrjedh në një mënyrë disi origjinale, si pasojë e konteksteve të veçanta kulturore, sociale dhe politike kosovare. Këtu absurdi shfaqet si një mënyrë për të përshkruar së pari jetën nën represion, mungesën e lirisë dhe pastaj ballafaqimin me to dhe mepakuptimësinë që krejt papritur i shoqëron ato. Në këtë kontekst, absurdi nuk është thjesht zgjedhje estetike, por domosdoshmëri për të komunikuar përvoja që nuk mund të shpreheshin ndryshe, për shkak të mungesës së lirisë apo frikës dhe subsituimit të tyre në rrethana të reja të krijuara pasluftës. Në vend të shtypjes nga jashtë, tani autori përballet me zhgënjimin e brendshëm, me zhvillimet shoqërore që nuk përmbushin idealet për të cilat ishte zhvilluar lufta. Ai shpërfaq absurditetin e tranzicionit, korrupsionin, boshllëkun moral dhe krizën e identitetit. Kështu, absurdi nuk zbehet a

evitohet, por rikonfigurohet si rrjedhojëe luftës, duke u bërë i ndërlikuar dhe i paparashikueshëm.

Tregimi *Te dera e çmendinës* paraqet një përvojë të thellë ekzistenciale të individit në një botë të çoroditur dhe të përmbysur. Absurdi këtu bëhet formë e shpërbërjes së realitetit, ku kufiri mes asaj që ndodh dhe asaj që imagjinohet është i paqartë. Personazhet jetojnë në një botë pa orientim moral, pa qëllim të qartë, të mbërthyer në zbrazëti dhe të përndjekur nga një lloj dhimbjeje e pashpjegueshme. Përmes këtij stili narrativ, autori e shtrin vizionin e tij absurd mbi shoqërinë kosovare të para dhe pasluftës – një shoqëri në iluzion, në zbrazëti apo në pritje të një kuptimi që nuk vjen kurrë, si te tregimi *Sagë e pakryer*.Gjithnjë në këtë frymë, tregimet e *Pengut të dollisë* njohin absurdin si gjendje të një realiteti të pashmangshëm dhe njëkohësisht si një sfidë përjetimi e kuptimi, një sfidë e thellë dhe tronditëse.

Te tregimi *Aroma e gjahut* lexojmë një storje gjahu, histori e lashtë sa vetë letërsia – një temë kjo që më ka intriguar personalisht, që nga rrëfimet e pafundme të gjahut, të gjuetarit që kam njohur në fëmijëri, tregime që linin shijen e përzier të imagjinares që përzihej me trillimin dhe gënjeshtrën. Edhe më vonë, letërsia e gjahut, që provokonte në mua imagjinatën e gënjeshtrës, m'u rishfaq nëpërmjet tipareve që Platoni i atribuonte letërsisë, apo dhe nëpërmjet rrëfimeve të një miku -teksa po i hidhnim hapat e parë në terrenin e lëkundshëm të letërsisë -për një temë gjahu për kaprollin, të motivuar nga jeta e Montenjit. Tregimi i Zejnullahut ishte një ritakim i befasishëm me këtë temë, ndaj e përjetova si tregim që ngjalli brenda meje mahnitjen me subjektin e me stilin. Rrjedhimisht, tregimi i tij për drenushën, më dhuroi një katarzë të pashoqe në rrëfimtarinë shqipe.

Në përmbyllje, *Pengu i dollisë* ndjek gjurmëte origjinave të absurditdhe të kuptimit të gjahut, duke na joshur të ngremë dolli për atë që Barthes-i e quante *plaisir de texte*; për shijen dehëse të prozës së mirërrëfimtare që na la ky libër i Sevdail Zejnullahut.